



SHTYJINI MË TEJ KUFIJTË TUAJ KRIJUES

imagePRESS C270 nga Canon.

Jua bën më të lehtë të bëni më shumë

Canon

NJË NDËRTHURJE E FUQISHME: FUNKSIONE DHE CILËSI

Tani keni shanse të pafundme për të tërhequr vëmendjen me anë të materialeve të printuara që bien në sy. Ndaj dhe ju duhet një printer elektronik që ju bën të mundur t'i shtyni më tej kufijtë tuaj krijues, por që është dhe i lehtë në përdorim.

Mënyra se si po punojmë po ndryshon. Shumë prej nesh po kalojnë shumë më pak kohë në zyrë, duke zvogëluar takimet ballë për ballë dhe duke kaluar shumë kohë në internet. Me një përqindje kaq të lartë të kohës sonë të kaluar në kanale digjitale, komunikimi efikas me klientët po bëhet gjithnjë e më sfidues. Printimi krijues dhe cilësor po rezulton një mënyrë efikase për të filluar ruajtjen e komunikimit.

Ju duhet të keni mundësinë të krijoni printime me efikasitet kostoje, që bien në sy dhe ngjallin reagime. Por ne e kuptojmë që mund të keni hezitim të investoni në teknologji printimi me cilësi të lartë nëse tashmë punoni me partnerë të jashtëm për diçka të tillë. Tanimë ka një alternativë. Biznesi juaj

mund të prodhojë vetë asete cilësore me efikasitet kostoje dhe rendiment duke investuar në imagePRESS C270 nga Canon. Kjo zgjidhje fleksibël ju ofron më të mirën e të dy botëve: një printer i përditshëm ekonomik që ju mundëson të krijoni dhe printime niveli profesional.

Ai ndërthur funksionet kyçe të teknologjisë imagePRESS nga Canon – cilësinë vazhdimisht të lartë të printimit, rendimentin fantastik dhe qëndrueshmërinë e provuar – të gjitha këto me familjaritetin dhe thjeshtësinë e gamës së vlerësuar imageRUNNER ADVANCE për ambiente zyrrash. **Kini vetëbesim. Është çasti të çlironi potencialin e biznesit tuaj me shfrytëzimin e printimeve krijuese.**

JUA BËN MË TË LEHTË TË BËNI MË SHUMË

imagePRESS C270 është zgjidhja për të gjitha nevojat tuaja të printimit. Në çdo biznes kjo pajisje fleksibël shumëfunktionale i përballon me lehtësi ciklet ditore të punës me dokumente ndërsa ju jep dhe mundësinë të printoni materiale marketingu të cilësisë së lartë.

Zgjeroni kapacitetet tuaja të printimit


- Realizoni printime me pamje profesionale të cilësisë së lartë
- Fleksibilitet për t'u përballur me lehtësi me kërkesa të thjeshta e të ndërlikuara
- Krijoni gjithçka, nga dokumentet e biznesit deri te materialet e marketingut
- Ruani ngjyra koherente për integritetin e markës në të gjitha materialet tuaja
- Realizojini në ambientet tuaja printimet që tërheqin shikime dhe dilni në treg më shpejt e me kosto më të ulëta

Risni angazhimin e personave të interesit

- Bashkëpunoni me efikasitet me cikle pune me informacion të njëzuar
- Kombinoni komunikimet promovionale për të angazhuar klientelën
- Tërhiqni vëmendjen me formate të freskëta dhe materiale me relief
- Përmirësoni eksperiencën e markës suaj me printime të cilësisë së lartë
- Personalizojini printimet për të nxitur reagimin ndaj fushatave

Zbatime tipike të imagePRESS C270 në një ambient shitjeje





FUTNI LETËR – MERRNI MUNDËSI

Printimi krijues mund të bëjë diferencën në audiencën tuaj, qoftë nëse është prezantim i brendshëm apo për një material reklamimi postar. Prekja e materialeve të printuara këndell shqisat. Personalizimi kuptimplotë përmirëson eksperiencat për klientët. Printimi nxit angazhimin dhe krijon vlerë.

Në të kaluarën mbase keni mbetur disi të tërhequr për shkak të kapacitetit të printerit tuaj, por tani jo më. Me modelin e ri të imagePRESS C270 nga Canon mund ta transformoni letrën e bardhë në material krijues e angazhues. Me shtypjen e një butoni mund të printoni një larmi materiale. Manuale, raporte e prezantime, kartëvizita, reklamim të personalizuar postar dhe madje edhe paketime në tirazhe të ulëta. Të gjitha në standarde profesionale. Tani është më e shpejtë dhe e thjeshtë që të bëni më shumë me një pajisje të vetme.

Bëhuni krijues. Jepni rezultate

Me imagePRESS C270 mund të krijoni printime që imponojnë vëmendje, që nxisin angazhimin e klientelës dhe ngjallin reagime.

Jini të ndryshëm, përdorni përmasa të pazakonte letre, peshë më të rënda dhe materiale me relief për të rënë në sy. Kapni punë të reja me anë të komunikimeve më të fokusuar.

- Raporte dhe prezantime
- Broshura, katalogë dhe manuale
- Materiale promocionale, ku përfshihen ato për pikat e shitjes
- Reklamim postar
- Kartëvizita dhe ftesa
- Skica e boca dizajni
- Printime afishesh e posterësh
- Paketim i personalizuar tirazhi të ulët

Ktheni faqen për të parë kombinimin e teknologjive të Canon që e bëjnë imagePRESS C270 kaq fleksibël.

ÇFARËDO BIZNESI. MUNDËSI TË PANUMËRTA. NJË ZGJIDHJE

Cilësia e një pajisjeje profesionale, lehtësia e përdorimit të një printeri zyre. Një zgjidhje që jua bën më të lehtë të bëni më shumë.



imagePRESS C270 ofron një gamë të larmishme materiale të printuara sipas kërkesës. Është ndërthurja ideale e funksioneve të zyrës me cilësinë profesionale, që mund t'ju ndihmojë të përballoni kërkesat gjithnjë në ndryshim të biznesit, si dhe t'ia dilni mbanë me vetëbesim detyrave të përditshme.

Dhe me synimin për të **printuar në fletë më të gjata** ose **stoqe më të rënda letre**, mund t'i shtyni kufijtë krijues dhe të realizoni më shumë me një printer të thjeshtë.

Mbase jeni pjesë e një agjencie krijuese që kërkon të impresionojë klientët me formate dhe efekte të reja.

Ose mbase jeni në ambient korporate dhe thjesht dëshironi të thjeshtoni zinxhirin e komunikimit, duke shtyrë njëherësh më tej kufijtë e krijimtarisë.

Mbase keni një dyqan fotokopjimi dhe dëshironi të krijoni kanale të reja të ardhurash duke u ofruar më shumë klientëve tuaj.

Apo mos jeni një biznes i vogël dhe dëshironi të provoni printime të ndryshme promovionale për të angazhuar klientelën tuaj në një mënyrë të thjeshtë e të njësuar.

Kompakt dhe intuitiv në përdorim, pa nevojën për ekspertizë në printim, **është një gjetje ideale për çfarëdo ambienti biznesi.**

Arrini cilësi profesionale printimi me lehtësi

- Figura të mprehta, rezolucioni të lartë, falë "imagePRESS R-VCSEL Laser"
- Regjistrim i përpiktë para-pas për cilësi të përpiktë figure
- Cilësi koherente me "Multi-Density Adjustment Technology (DAT)"
- Aftësi finicioni të integruar për printime krijuese
- Menaxhim i thjeshtë i ngjyrave me funksionin e kalibrimit të ngjyrave "i1PRO" për koherencë dhe kontroll cilësie

Nga fletët bosh deri te materialet tërheqëse

- Printim në fletë të gjata deri në 1300 mm
- Printim në materiale deri në 220 g/m² në dyanëshe automatike dhe 350 g/m² në dyanëshe manuale
- Aftësi pune me materiale me motive dhe me relief
- Përmasa letre SRA3 dhe A4, si dhe zarfe
- Funksione personalizimi/printimi me të dhëna të ndryshueshme

Rrisni efikasitetin e biznesit dhe sigurinë

- Instalim dhe konfigurim i thjeshtë
- Printer shumëfunktional me ndërfaqen familjare dhe intuitive të përdorimit "imageRUNNER ADVANCE" dhe me funksione shoqëruese gjatë punës
- Integrim i lehtë; platformë shumëfunktionale zbatimi të integruar (MEAP)
- Integrim i njësuar me renë kompjuterike dhe ciklet e punës së përdoruesve
- Siguri në renë kompjuterike me anë të softuerit për menaxhimin e pajisjeve "uniFLOW Online Express" (si standard, por ofrohen edhe versione të posaçme) gjurmim dhe kontroll i përdoruesve, kostove dhe buxheteve
- Produktiviteti i lartë me deri në 70 faqe në minutë me ngjyra dhe 80 faqe në minutë në bardhezi dhe 270 imazhe në minutë skanim
- Mbrojtje e integruar McAfee

Zgjedhje e cikleve të punës

- Personalizojini ciklet e punës me një përzgjedhje pultesh intuitive që i përshtaten biznesit tuaj:
 - Canon PDL: UFR II, PCL 6 PostScript
 - EFI e brendshme

MË INTELIGJENT SE Ç'MENDONI

imagePRESS C270 është zgjidhje inteligjente për të gjitha nevojat e biznesit tuaj, përplot me funksione për të garantuar prodhim efikas. Jua heq punën më të rëndë nga procesi i printimit, që të mund të fokusoheni në rritjen e biznesit tuaj.

Zbatimet tipike të imagePRESS C270 për sektorin e shëndetësisë



Siguri

Të dhënat e biznesit tuaj duhet t'i mbani të sigurta. Falë uniFLOW Online Express si standard, imagePRESS C270 ju ofron një shërbim tërësor e të gatshëm menaxhimi printimesh nga interneti. Ai punon më së miri me proceset tuaja ekzistuese, jua sjell nën kontroll kostot në lidhje me printimit, ju ofron siguri të përmirësuar për dokumentet - për mbrojtjen e të dhënave dhe të pronës suaj intelektuale - si dhe rrit produktivitetin e punonjësve.

Për funksione të mëtejshme mund të kaloni te "uniFLOW Online" për të përfituar nga një softuer i plotë dhe i sigurt menaxhimi të printimeve përmes resë kompjuterike me printime me porosi.



Portativitet

Shumë opsione për të printuar e skanuar nga kudo drejt çfarëdo pajisjeje "Canon" dhe për të ofruar printim portativ në vend për vizitorët, duke përfshirë:

- Aplikacionin "Canon PRINT Business"
- uniFLOW Online"
- Mopria Print Service
- Funkzionin e lidhjes së drejtpërdrejtë me pajisjen



Produktivitet për përdoruesit


"uniFLOW Online"*** ju përmirëson produktivitetin duke krijuar cikle të posaçme pune për regjistrimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e dokumenteve elektronike. Mund të gjurmoni me saktësi shpenzimet dhe rregullat e caktuara, të fshini automatikisht punët e paqarkulluara dhe të printoni vetëm materialet që ju duhen. Prodhoni numrin e saktë të kopjeve që ju duhen, atëherë kur ju duhen. Me printimin me porosi nuk keni mbetje dhe nuk keni stoqe për magazinim. Mund të zhvilloni fushata dinamike duke i përditësuar mesazhet, nismat dhe masat në rrugë e sipër.

Me imagePRESS C270, ju përftoni një zgjidhje të qëndrueshme teknologjike që nuk do t'ju lërë kurrë në baltë, si dhe shërbime elektronike mirëmbajtjeje për të pasur mbështetje parandaluese teknike sa herë që t'ju nevojitet.



Menaxhim i kostove

Zgjidhja jonë e resë kompjuterike ju mundëson gjurmimin dhe kontrollin e resurseve të përdorimit dhe të aplikacioneve. Ajo vjen me kosto të ulët fillestare dhe me funksione të thjeshta. Mund të menaxhoni kosto printimi, të ndihmoni në ndryshimin e veprimeve që sjellin shpenzime të panevojshme dhe të kufizoni apo ndaloni aksesin.



Menaxhim i lehtë i pajisjes dhe i flotave

"uniFLOW Online"*** regjistron, arkivon dhe ndan informacion, që të mund të centralizoni kontrollin e të gjitha cikleve të punës për dokumentet dhe të lehtësoni kështu bashkëpunimin.

Përditësimet automatike të softuerit nga interneti ju japin fleksibilitet dhe ju lirojnë kohë për t'u fokusuar në mundësi të tjera të zhvillimit të biznesit. Diagnostikimi dhe mbështetja në distancë ju ndihmojnë të ulni shpenzimet duke reduktuar kohën e qëndrimit pa punë dhe të proceseve manuale. Duke përdorur "imageWARE Management Console" ju keni një pikë qendrore kontrolli mbi të gjithë flotën tuaj të pajisjeve anembanë botës.



Qëndrueshmëri

Përdorimi efikas i energjisë, një opsion verifikimi për të reduktuar mbetjet, modaliteti pasiv kur printeri nuk është në përdorim dhe një sensor inteligjent i lëvizjes e bëjnë modelin imagePRESS C270 një zgjedhje ekologjike.

* (ofrohet në "Google Play" dhe në "App Store")
** Nuk ofrohet si standard

MË E MIRA E TË DYJA BOTËVE

Funksionet bazë të imagePRESS C270 me një shikim të shpejtë



Formate unike e krijuese

Gjatësi të ndryshme
materialesh deri në 1300
mm dhe pesha deri
në 350 g/m²



I shpejtë dhe reagues

deri në 70 faqe në minutë
me ngjyra dhe deri në 80
faqe në minutë bardhezi



Rezultat me cilësi të lartë

Rezolucion i lartë,
printim i përpiktë



Aftësi profesionale

Opsione të lehta finicioni




Ngjyra koherente

Administrim intuitiv
i ngjyrave, nuk duhet
përvojë paraprake



Printim portativ

Nga kudo, në çdo kohë,
për produktivitet
më të lartë



Kompakt

Përmasa të vogla për
hapësira të kufizuara



I sigurt dhe me opsione lidhjeje

Komandim me bazë
reje kompjuterike dhe
monitorim i përdorimit



NJË PARTNERITET TEK I CILI MUND TË KENI BESIM

Te "Canon" ju do të gjeni një partner të besuar teknologjik,
si për sot, ashtu edhe për të ardhmen. Ne jemi këtu për t'ju
ndihmuar të maksimizoni potencialin e biznesit tuaj.



Zbatimet tipike të
imagePRESS C270 për
sektorin e shërbimeve
financiare

Si drejtues i tregut

"Canon" është një markë e besuar
në shkallë botërore me mbi 80
vite eksperiencë. Trashëgimia
jonë në linjën "imagePRESS" na
ka bërë një prej drejtuesve të
tregut në teknologjitë e printimit
të njësuar elektronik. Klientët na
kanë dhënë besimin e tyre për
gjetjen e risive teknologjike që
kanë gjithashtu mbështetjen e
partnerëve specialistë për ciklet
e punës, për t'ju ofruar kështu
zgjidhje që u përshtaten nevojave
specifike të biznesit tuaj.

Mbështetje e vazhduar shërbimi

"Canon" ka njohuri dhe ekspertizë
në zhvillimet më të fundit në
teknologjinë e printimeve
elektronike, si dhe në materiale
dhe aplikacione. Mbi 4000
ekspertë servisi u përkushtohen
nevojave tuaja - "Canon" ka një
databazë që hapet nga të gjithë
teknikët tanë për korrigjime,
përditësime dhe ndarje përvojë,
pavarësisht vendndodhjes së
secilit, për të maksimizuar kohën
e punës së çdo pajisjeje.

Programi për mbështetjen e biznesit

"Canon" ofron konsulencë dhe
mbështetje të vazhduar për t'ju
ndihmuar të nxirrni maksimumin
nga investimi juaj.

**Për të mësuar më shumë se si mund ta mbështesim biznesin tuaj, kontaktoni me përgjegjës
caktuar llogarisë suaj**

Canon

Canon Inc.
canon.com

Canon Europe
canon-europe.com

Albanian edition
© Canon Europa N.V., 2025
